



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr.147

19 nëntor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7811 datë 8.11.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	8101
Vendim i KM nr. 706, datë 17.10.2012	Për miratim, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për bashkëpunimin ekonomik.....	8101
Vendim i KM nr. 710, datë 24.10.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 420, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si edhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2012-2013”.....	8105
Vendim i KM nr. 715, datë 16.10.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 79, datë 2.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë aksionare ndërmjet Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim rindërtimin, modernizimin dhe administrimin e stadiumit kombëtar “Qemal Stafa”.....	8107
Vendim i KM nr. 718, datë 16.10.2012	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	8107
Vendim i KM nr. 719, datë 16.10.2012	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione ushtarake në shtabe të ndryshme në Afganistan”, të ndryshuar.....	8108

Vendim i KM nr. 720, datë 16.10.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 548, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë “Master i Shkencave”/“Master i Arteve të Bukura” për vitin akademik 2012-2013”	8109
Vendim i KM nr. 721, datë 16.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të spotit televiziv të 100 - Vjetorit të Pavarësisë.....	8110
Vendim i KM nr. 722, datë 16.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për realizimin e projektit kulturor “Baleti Preljocaj” me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.....	8110
Vendim i KM nr. 723, datë 16.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për shpërblimin artistik të arkitektëve fitues, z. Visar Obrija dhe z. Kai R. Kiklas, në konkursin ndërkombëtar për veprën monumentale “100 Vjet Pavarësi”	8111
Vendim i KM nr. 724, datë 16.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për bashkinë Lushnjë, për financimin e bazamentit të monumentit kushtuar Kongresit të Lushnjës, që do të vendoset në këtë qytet.....	8111
Vendim i KM nr. 725, datë 16.10.2012	Për emërim në detyrë.....	8112
Vendim i KM nr. 727, datë 24.10.2012	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	8112
Vendim i KM nr. 728, datë 24.10.2012	Për rishpërndarje fondesh buxhetore për shpenzimet korente, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë në buxhetin e vitit 2012.....	8113
Vendim i KM nr. 729, datë 24.10.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 554, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për fondin e ekselencës, për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer”, të ndryshuar.....	8114
Vendim i KM nr. 730, datë 24.10.2012	Për disa shtesa në vendimin nr. 545, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2012 - 2013”	8114

Vendim i KM nr. 731, datë 24.10.2012	Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare - amfibe “Albanian Lion - 2012”	8116
Vendim i KM nr. 733, datë 2.11.2012	Për përzgjedhjen, me procedurë të përshpejtuar, të një studioje të huaj avokatie për të përfaqësuar Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar me paditës shoqërinë “Sky Petroleum INC”	8117
Vendim i KM nr. 734, datë 2.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e kështit të dytë dhe të tretë të shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. Arb/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A. kundër Republikës së Shqipërisë”	8118
Vendim i KM nr. 735, datë 2.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e kështit të dytë dhe të tretë të shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. Arb/11/18 “Burimi s.r.l. & Eagle Games sh.a., kundër Republikës së Shqipërisë”	8118
Vendim i KM nr. 736, datë 2.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për projektin “Vendosja e Bustit të Skënderbeut në Londër, në nëntor 2012”	8119
Vendim i KM nr. 791, datë 14.11.2012	Për miratimin e strukturës e të organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil	8120
Vendim i GJK nr. 51, datë 7.11.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2010-719 (551), datë 28.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	8126
Vendim i ERE nr. 150, datë 31.10.2012	Për fillimin e procedurave ligjore për kontraktimin e një konsulenti ligjor që do të asistojë ERE-n në mosmarrëveshjet e krijuara me shoqërinë “Cez Shpërndarje” sh.a.....	8130
Kërkesë e MPPT nr. 4488/1, datë 8.11.2012	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash-Morinë”	8131
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Erion Korobacja	8132

DEKRET
Nr. 7811, datë 8.11.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Samer Said El Zaatari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 706, datë 17.10.2012

PËR MIRATIM, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
BULLGARISË, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për bashkëpunimin ekonomik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË

PREAMBULË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë (më poshtë të quajtura “palët kontraktuese”),

duke pranuar nevojën e përmirësimit të mëtejshëm dhe një përcaktimi më të hollësishëm të bazës kontraktuale dhe ligjore të marrëdhënieve ekonomike dypalëshe,

duke konfirmuar vullnetin e tyre për të zhvilluar ndikimin pozitiv të marrëdhënieve të tyre ekonomike tradicionale,

duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në gjetjen e mjeteve dhe mënyrave për fuqizimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit me përfitim reciprok,

duke marrë në konsideratë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që rrjedhin nga anëtarësimi në BE i Republikës së Bullgarisë, nga Traktati i Bashkimit Europian, Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Marrëveshja e Aderimit e Republikës së Bullgarisë dhe Rumanisë në Bashkimin Europian dhe nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian dhe shteteve të tyre anëtare, nënshkruar më 12 qershor 2006,

të bindur se kjo marrëveshje do të kontribuojë në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet tyre në realitetin e ri dhe veçanërisht në forcimin e bashkëpunimit tregtar, ekonomik, teknik dhe teknologjik me përfitim reciprok,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese kontribuojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit të tyre ekonomik me përfitim reciprok.

Neni 2

Palët kontraktuese bëjnë përpjekje për të zhvilluar bashkëpunimin e tyre dypalësh me bazë të gjerë, veçanërisht në fushat e përcaktuara në aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Palët kontraktuese zhvillojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e tyre ekonomik nëpërmjet zbatimit të masave të përcaktuara në aneksin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese ngrenë një komision ndërqeveritar bullgaro-shqiptar për bashkëpunimin ekonomik, me detyra dhe rregulla procedurale sipas specifikimit në aneksin 3 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5

Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare në të cilat Republika e Bullgarisë dhe Republika e Shqipërisë janë palë dhe/ose nga anëtarësimi i tyre në organizata ndërkombëtare.

Neni 6

Palët kontraktuese zgjidhin me anë të bisedimeve çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje bëhen nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët ndërmjet palëve kontraktuese, të nënshkuara në protokolle të veçanta për çdo ndryshim. Ato hyjnë në fuqi sipas nenit 9 paragrafi 1 i kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Anekset dhe protokollet e kësaj marrëveshjeje janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 9

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit me të cilin palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën se procedurat e brendshme të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë përbushur.

2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar.

3. Secila palë kontraktuese në këtë marrëveshje mund të përfundojë këtë marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër kontraktuese. Përfundimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit të katërt pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga pala tjetër kontraktuese.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Tiranë më _____ në dy kopje në gjuhën bullgare, shqipe dhe angleze, ku secila prej këtyre teksteve është njëllëj autentike. Në rast mospërputhjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

ANEKSI 1

Fushat e bashkëpunimit ekonomik përfshijnë:

1. Industri:

- ndërtim makinash;
- metalurgji;
- industri përpunuese;
- elektronike dhe ndërtim makinerish elektrike;
- industri ndërtimi;
- industri kimike dhe rafineri naftë;
- industri farmaceutike.

Nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve, në të cilën paraqitet me interes zhvillimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojës me strukturat dhe institucionet shtetërore të Bullgarisë, si një vend anëtar i BE-së, në fushën e praktikave ligjore, administrative



dhe teknike: punimi i metaleve dhe veçanërisht prodhimi i konstruksioneve dhe i pajisjeve të çelikut, një dege ku është investuar nga biznesi vendas si në teknologji, edhe në burimet njerëzore.

Bujqësi:

- prodhim të korrash;
- mbarështim blegtoral;
- industri ushqimore;
- prodhim organik.

Pylltari;

Bashkëpunim ekonomik ushtarak;

Sektor i energjisë;

Kërkim dhe zhvillim;

Ndërtim dhe industri ndërtimi;

Telekomunikacion dhe informatikë;

Transport dhe logjistikë;

Mbrojtje mjedisi dhe menaxhim i ujërave;

Turizëm;

Nxitje e investimeve;

Bashkëpunim i SME-ve;

2. Arsim;

3. Kujdes shëndetësor;

4. Shkencë dhe teknologji.

ANEKSI 2

MASAT QË ZGJEROJNË DHE INTENSIFIKOJNË BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

1. Fuqizimi i bashkëpunimit ekonomik i institucioneve qeveritare, organizatave profesionale dhe qarqeve, dhomave dhe shoqatave të biznesit, organeve rajonale dhe lokale, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit ekonomik të interesit reciprok, si dhe vizitat e ndërsjella të përfaqësuesve të institucioneve dhe biznesit të dy palëve.

2. Ofrimi i stimujve për vendosjen e kontakteve të reja dhe intensifikimin e atyre ekzistuese të biznesit, duke nxitur kontaktet e ndërsjella dhe vizitat e personave privatë dhe sipërmarrësve.

3. Shkëmbimi i informacionit për biznesin, pjesëmarrja në panairë dhe ekspozita ndërkombëtare, dhënia e asistencës për organizimin e aktiviteteve për përfaqësuesit e biznesit, seminareve, konferencave dhe simpoziumeve.

4. Kontribuimi për një rol të fuqizuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në marrëdhëniet ekonomike dypalëshe.

5. Bashkëpunimi në fushën e marketingut, konsulencës dhe shërbimeve të ekspertëve në fushat e interesit të përbashkët.

6. Zhvillimi i marrëdhënieve më të ngushta dhe bashkëpunimi i institucioneve financiare dhe bankare.

7. Dhënia e asistencës për zhvillimin e aktivitetit të investimeve dypalëshe.

8. Dhënia e asistencës për hapjen e përfaqësive dhe degëve të shoqërive nga të dyja palët.

9. Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar.

10. Fuqizimi i bashkëpunimit në tregjet e vendeve të treta.

11. Shkëmbimi i informacionit për programet dhe projektet, duke inkurajuar përfshirjen e sipërmarrësve në zbatimin e tyre.

ANEKSI 3

DETYRAT, STRUKTURA DHE RREGULLAT PROCEDURALE TË KOMISIONIT NDËRQEVERITAR BULLGARO-SHQIPTAR MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

1. Detyrat e Komisionit Ndërqeveritar Bullgaro-Shqiptar mbi Bashkëpunimin Ekonomik që më poshtë quhet “Komisioni”, përfshijnë:

- Diskutimin e çështjeve të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike dypalëshe;
- Identifikimin e mundësive të reja të zhvillimit për marrëdhëniet ekonomike dypalëshe;
- Zhvillimin e propozimeve për përmirësimin e mjedisit për bashkëpunimin ekonomik të organizatave të të dyja palëve;
- Paraqitjen e propozimeve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Komisioni përfshin përfaqësues të palës bullgare dhe të palës shqiptare.

Secila palë kontraktuese cakton një kryetar nga ana e vet që quhet “bashkëkryetar”. Secili bashkëkryetar cakton një sekretar për pjesën përkatëse të Komisionit.

Për diskutimin e çështjeve të veçanta, Komisioni mund të vendosë të ngrejë grupe pune, duke përcaktuar detyrat e tyre dhe afatet kohore për zbatimin e detyrave.

3. Komisioni mbledhet të paktën një herë në vit, me zgjedhje të alternuar në Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Shqipërisë.

Bashkëkryetarët bien dakord për thirrjen dhe agjendën e mbledhjes përkatëse të Komisionit, jo më vonë se një muaj përpara.

Çështjet që nuk janë vendosur shprehimisht në agjendën paraprake mund të diskutohen në mbledhjet e Komisionit me marrëveshjen e bashkëkryetarëve.

Një mbledhje e jashtëzakonshme e Komisionit ose e bashkëkryetarëve mund të thirret me propozim të një prej bashkëkryetarëve.

Këshilltarët dhe ekspertët mund të ftohen në mbledhjet e Komisionit.

Gjuha e punës e Komisionit është gjuha angleze. Për çdo mbledhje dhe diskutimet e zhvilluara në to mbahet procesverbal, i cili përpilohet në gjuhën angleze.

Në periudhën ndërmjet mbledhjeve, bashkëkryetarët e Komisionit ose sekretarët, me udhëzim të bashkëkryetarëve, diskutojnë në mënyrë operative çështjet në lidhje në punën e Komisionit.

VENDIM

Nr. 710, datë 24.10.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 420, DATË 27.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, CIKLI I PARË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI EDHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm,



të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, si dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 420, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në vitin akademik 2012-2013, 3 (tre) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë-preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Përjashtim bëjnë Universiteti i Arteve dhe Akademia e Arteve Shkodër, në të cilat 3 (tre) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë-preferencë) në nivel fakulteti, nuk paguajnë tarifën vjetore të shkollimit.”.

2. Pika 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“19. Pranimi i studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet nëpërmjet parimit meritë-preferencë dhe kryhet në dy raunde (me dy formularët A2 dhe A3).

19.1 Shpërndarja e fituesve në programe të ndryshme studimi, të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në mënyrë të informatizuar, duke u mbështetur në rezultatet e shkollës së mesme, të Maturës Shtetërore (merita), si dhe të përzgjedhjes së programeve të studimit (preferenca), të bërë nga vetë kandidati/ja. Raundi i parë (aplikimi me formularin A2) zhvillohet në dy faza: regjistrimi *on line* dhe dorëzimi i dokumentacionit shtesë pranë institucioneve të arsimit të lartë publik ku janë shpallur fitues.

19.2 Kuotat që mbeten të porealizuara për çdo program studimi pas aplikimit me formularin A2, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të propozimeve të institucioneve publike të arsimit të lartë.

19.2.1 Në raundin e dytë kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë maturantët/kandidatët, që kanë konkurruar në raundin e parë me të njëjtën renditje preferencash të atij raundi, me përjashtim të:

a) fituesve të preferencës së parë, të cilët janë regjistruar në këtë program studimi;

b) maturantëve/kandidatëve, të cilët nuk kanë kërkuar vazhdimin e konkurrit për preferenca më të larta gjatë regjistrimit *on line* dhe që rezultojnë të regjistruar në programin e studimit të preferuar.

19.2.2 Formulari A3 përfshin programet e studimit të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë me kuotat respektive të shpërndara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët:

a) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2;

b) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e vjeshtës 2012;

c) kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë Republikës së Shqipërisë dhe u janë ekuivalentuar rezultatet e shkollës së mesme dhe provimet e Maturës Shtetërore;

ç) kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë (të vjeshtës) dhe rezultojnë kalues në provimet me zgjedhje.

19.2.3 Kuotat që mbeten të porealizuara edhe pas regjistrimit të fituesve të shpallur nga aplikimi në raundin e fundit, nuk rishpallen.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 715, datë 16.10.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 79, DATË 2.2.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE NDËRMJET FEDERATËS
SHQIPTARE TË FUTBOLLIT DHE MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE, ME QËLLIM RINDËRTIMIN, MODERNIZIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E STADIUMIT KOMBËTAR “QEMAL STAFA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr. 79, datë 2.2.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Kapitali fillestar i shoqërisë së re është vlera e Stadiumit Kombëtar “Qemal Stafa”, në shumën prej 7 112 117 000 (shtatë miliardë e njëqind e dymbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekësh. Raporti i aksioneve në krijimin e shoqërisë anonime të re është:

- 25% shteti, i përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për sportin;
- 75% Federata Shqiptare e Futbollit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 718, datë 16.10.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh, ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin “mbështetja shëndetësore”, art. 602, shpenzime korente, të shtohet fondi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.

b) Në programin “bashkëpunimi civilo-ushtarak”, art. 600, të pakësohet fondi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 719, datë 16.10.2012

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE NË SHTABE TË NDRYSHME NË AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1.3, fjalët “... 31 gusht ...” zëvendësohen me “... 30 shtator ...”.

b) Pas pikës 1.6 shtohet pika 1.7 me këtë përmbajtje:

“1.7 Në Shtabin e Komandës Rajonale Perëndimore (RC-W), “ISAF”, Afganistan.

- Misioni: Mbështetje dhe dhënie kontributi në funksione të ndryshme në Shtabin e Komandës Rajonale Perëndimore, në operacionin ushtarak të NATO-s, “ISAF”, Herat, Afganistan.

- Numri i pjesëmarrësve, 3 (tre) ushtarakë.

- Kohëzgjatja deri në 2 (dy) vjet, afat, i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të kontingjentit në Afganistan. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

- Venddislokimi, Herat, Afganistan.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 720, datë 16.10.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 548, DATË 16.8.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE, ME KOHË TË PLOTË “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE
TË BUKURA” PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e studimit të disa programeve të studimit, në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i arteve të bukura”, në Universitetin e Arteve të Tiranës, të përcaktuara në tabelën nr. 1 bashkëlidhur vendimit nr. 548, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Arteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR. 1
TARIFAT E STUDIMIT TË DISA PROGRAMEVE MASTER I ARTEVE TË BUKURA
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE TË TIRANËS

Universiteti	Fakulteti	Nr. i programit	Programi	Tarifa për kredit 2012-2013 (në lekë)	Tarifa totale për program 2012-2013 (në lekë)
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	166	Aktrim	1,456	174,720
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	167	Koreografi	1,456	174,720
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	168	Regji Filmi dhe TV	1,456	174,720
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	169	Regji Teatri dhe Spektakli	1,456	174,720
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	170	Skenografi-kostumografi	1,456	174,720
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	186	Muzikologji	1,456	174,720



VENDIM
Nr. 721, datë 16.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE TË REALIZIMIT TË SPOTIT TELEVIZIV
TË 100 - VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi në shumën 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të spotit televiziv të 100 - Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 722, datë 16.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
KULTUROR “BALETI PRELJOCAJ” ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 6 493 200 (gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tri mijë e dyqind) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të projektit kulturor “Baleti Preljocaj” me rastin e 100 - Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 723, datë 16.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR SHPËRBLIMIN ARTISTIK TË
ARKITEKTËVE FITUES, Z. VISAR OBRIJA DHE Z. KAI R. KIKLAS, NË KONKURSION
NDËRKOMBËTAR PËR VEPRËN MONUMENTALE “100 VJET PAVARËSI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 7 281 540 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet) lekësh, për shpërblimin artistik të arkitektëve fitues, z. Visar Obrija dhe z. Kai R. Kiklas, në konkursin ndërkombëtar për veprën monumentale “100 Vjet Pavarësi”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 724, datë 16.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR BASHKINË LUSHNJË, PËR
FINANCIMIN E BAZAMENTIT TË MONUMENTIT KUSHTUAR KONGRESIT TË
LUSHNJËS, QË DO TË VENDOSSET NË KËTË QYTET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Investime”, t’i shtohet fondi prej 5 070 646 (pesë milionë e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekësh, për bashkinë Lushnjë, për financimin e bazamentit të monumentit kushtuar Kongresit të Lushnjës, që do të vendoset në këtë qytet.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 725, datë 16.10.2012

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Arben Ristani emërohet Zëvendësministër i Brendshëm.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 727, datë 24.10.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin buxhetor 04240 “Infrastruktura e ujitjes dhe e kullimit”, në artikullin 231 “Investime”, t’i zbritet fondi prej 2 520 000 (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekësh.

2. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin “mbështetje për zhvillim ekonomik”, t’i shtohet në investime fondi prej 2 520 000 (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekësh, për implementimin e formularëve dhe përgatitjen e infrastrukturës së regjistrimit elektronik, në zbatim të ligjit nr. 38, datë 5.4.2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 728, datë 24.10.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE PËR SHPENZIMET KORENTE,
BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E DREJTËSISË NË
BUXHETIN E VITIT 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore, zëri “shpenzime korente”, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë në buxhetin e vitit 2012, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit t’i pakësohet fondi prej 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekësh, në shpenzimet e personelit.

b) Programit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave t’i pakësohet fondi prej 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekësh, në shpenzimet e personelit.

c) Programit të Shërbimit të Provës t’i pakësohet fondi prej 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh, për shpenzime personeli.

ç) Programit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, në shpenzimet e personelit.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 729, datë 24.10.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 554, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FONDIN E EKSELENCËS, PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË
STUDENTËVE E SHKENCËTARËVE TË RINJ, TË SHKËLQYER”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 554 datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “ ... deri në 100 000 000 (njëqind milionë) lekë në vit ...” zëvendësohen me “ ... 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë në vit ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 730, datë 24.10.2012

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 16.8.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE,
BURSAT E SHITIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2012 - 2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 25 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2.3 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nxënësve të klasës së 13-të të shkollave profesionale, drejtimi “Termohidraulikë”, që nuk kanë përfituar bursë me vendim të këshillave të njësive të qeverisjes vendore, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale, mbështetur në kërkesën e drejtorisë arsimore rajonale u akordohet/miratohet bursë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.”.

b) Në fund të pikës 12 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale për nxënësit e klasës së 13-të të shkollave profesionale, drejtimi “Termohidraulikë”, për vitin e ri akademik 2012 - 2013, të japë 456 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) muaj bursë. Analitikiisht, numri i nxënësve, muaj/ditë bursë kuotë ushqimore, niveli/masa e bursës jepen sipas pasqyrës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet publike të arsimit profesional dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr.	Emri i shkollës	DAR/ZA	Numri i bursave që do të transferohen		Totali i nxënësve që përfitojnë bursë	Periudha	Njësia e qeverisjes vendore pritëse	Gjithsej muaj bursa	Ditë praktike/ për tu trajtuar me kuotë ushqimore burse	Kuota ushqimore në lekë ditë	Totali në lekë/kuotë ushqimore
			Nr. i nxënësve të regjist. në klasën e 13*	Nga këta aktualisht përfitojnë bursë*				Për vitin akademik 2012-2013			
					A			B	C	D	E = AxCxD
1	Shkolla Mek. Profesionale	Lushnjë	16	0	16	4-29 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	16	25	206	82,400
2	“Beqir Çela”	Durrës	20	2	18	1 - 26 prill 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	18	26	206	96,408
3	“Salih Ceka”	Elbasan	44	2 + ½	41.5	26 nëntor 2012 - 1 shkurt 2013 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	83	55	206	470,195
4	“Karl Gega”	Tiranë	39	10	29	1 tetor 23 nëntor 2012 (2 muaj)	Bashkia Durrës	58	54	206	322,596
			39	10	29	26 nëntor-21 dhjetor 2012 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	29	25	206	149,350
5	“Rakip Kryeziu”	Fier	15	3	12	29 tetor - 23 nëntor 2012 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	12	27	206	66,744
			15	3	12	1 prill-24 maj 2013 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	24	54	206	133,488
6	Industriale “Pavarësia”	Vlorë	23	1	22	7 janar - 1 shkurt 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	22	24	206	108,768
			23	1	22	4 shkurt - 29 mars 2013 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	44	53	206	240,196
7	Shkolla e Ndërtimit	Korçë	22	0	22	4 shkurt - 1 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	22	25	206	113,300
			22	0	22	1 prill - 24 maj 2013 (2 muaj)	Bashkia Durrës	44	54	206	244,728
8	“Kolë Idromeno”	Shkodër	13	0	13	29 tetor - 23 nëntor 2012 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	13	25	206	66,950
			13	0	13	26 nëntor 2012 - 1 shkurt 2013 (2 muaj)	Bashkia Durrës	26	54	206	144,612
9	“Stiliano Bandilli”	Berat	11	1	10	1 tetor-23 nëntor 2012 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	20	54	206	111,240
			11	1	10	4 shkurt-1 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	10	24	206	49,440
10	“Thoma Papapano”	Gjirokastrë	9	4	5	4-29 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	5	25	206	25,750
			9	4	5	1 prill - 24 maj 2013 (2 muaj)	Bashkia Durrës	10	54	206	55,620
					301.5	Kosto totale e parashkuar në lekë		456	658	206	2,481,785



VENDIM
Nr. 731, datë 24.10.2012

**PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË
SË MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT DETARE - AMFIBE
“ALBANIAN LION - 2012”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare - amfibe “Albanian Lion - 2012”, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.
 2. Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) trupave ushtarakë të Britanisë së Madhe.
 3. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve joluftarake të evakuimit (NEO-Non-Combatant Evacuation Operations) nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije luftarake zbarkuese, helikopterë dhe forca speciale për veprimtaritë në tokë.
 4. Stërvitja zhvillohet në periudhën 3-18 nëntor 2012, në rajonin e gjirit të Vlorës, në Gadishullin e Karaburunit, ishullin e Sazanit, bazën e Porto-Palermos dhe në bazën ajrore të Kuçovës.
 5. Në këtë stërvitje angazhohen 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) trupa, 4 (katër) anije luftarake, 1 (një) helikoptermbajtës, 1 (një) fregatë e 2 (dy) anije zbarkuese dhe 11 (njëmbëdhjetë) helikopterë, të cilët do të kryejnë lëvizje gjatë 24 orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas pikës 4 të këtij vendimi. Në rajonin e Gadishullit të Karaburunit do të kryejnë veprimtari stërvitore 400 (katërqind) marinsa (forca speciale) të Forcave të Armatosura Mbretërore Britanike, të cilët do të simulojnë mbështetjen e operacionit nga toka.
 6. Trupat britanikë gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009.
 7. Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë trupat britanikë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
 8. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 733, datë 2.11.2012

**PËR PËRZGJEDHJEN, ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR, TË NJË STUDIOJE TË
HUAJ AVOKATIE PËR TË PËRFAQËSUAR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR ME
PADITËS SHOQËRINË “SKY PETROLEUM INC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 7, 5 pika 1 shkronja “b”, 12 pikat 2 e 6, 15 pika 8 e 18 pika 2 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtimisht procedurës dhe rregullave të përcaktuara në kreun III të rregullores së miratuar me vendimin nr. 392, datë 8.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale” dhe në kushtet e nevojës urgjente, të përzgjidhet, me procedurë të përshpejtuar, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim, një studio e huaj avokatie për të përfaqësuar Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar me paditës “Sky Petroleum Inc”.

2. Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e studios së huaj të avokatisë janë:

a) specialiteti i avokatit/zyrës së avokatisë në fushën e objektit të çështjes për të cilën është vendosur fillimi i procedurës së kontraktimit;

b) numri i çështjeve të fituara në procedime të ngjashme;

c) besueshmëria dhe reputacioni.

3. Kriteret e veçanta dhe termat e referencës të përgatiten nga Avokatura e Shtetit dhe t’u njoftohen studiove të huaja të avokatisë, në ftesën për ofertë, gjatë fazës së propozimit dhe negocimit.

4. Avokatura e Shtetit, pas përgatitjes së termave të referencës, ua dërgon ftesën për ofertë, të paktën, dy studiove ligjore të huaja.

5. Përzgjedhja e studios së huaj të kryhet pas vlerësimit të, minimalisht, dy ofertave nga Avokatura e Shtetit dhe negocimit të çmimit të propozuar.

6. Pas marrjes së ofertës nga, të paktën, dy studio të huaja avokatie, Avokatura e Shtetit përzgjedh studion fituese në bazë të çmimit, reputacionit dhe cilësisë së shërbimit.

7. Avokatura e Shtetit autorizohet të lidhë kontratë me studion fituese, e cila duhet të miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

8. Pas miratimit të kontratës së lidhur nga Ministri i Drejtësisë, Avokati i Përgjithshëm cakton një avokat shteti për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me subjektin e përzgjedhur.

9. Pas lidhjes së kontratës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton menjëherë Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i cili merr masa për të pajisur avokatin/zyrën e avokatisë së përzgjedhur me autorizimin përkatës për përfaqësim.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

8117



VENDIM
Nr. 734, datë 2.11.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E KËSTIT TË DYTË DHE TË TRETË TË SHËRBIMEVE
JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR NR. ARB/11/24 “MAMIDOIL JETOIL GREEK PETROLEUM
PRODUCTS SOCIETE ANONYME S.A. KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012 t’i shtohet fondi 70 000 (shtatëdhjetë mijë) euro, për të përballuar pagesat e tarifave avokatore të përfaqësimit (kësti i dytë dhe i tretë) për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A., kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve nga Investimet (ICSID).

2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 735, datë 2.11.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E KËSTIT TË DYTË DHE TË TRETË TË SHËRBIMEVE
JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR NR. ARB/11/18 “BURIMI S.R.L. & EAGLE GAMES SHA KUNDËR
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi 70 000 (shtatëdhjetë mijë) euro, për të përballuar pagesat e tarifave avokatore të përfaqësimit (kësti i dytë dhe i tretë) për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/18 “Burimi s.r.l. & Eagle Games 8118

sh.a., kundër Republikës së Shqipërisë që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve nga Investimet (ICSID).

2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 736, datë 2.11.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR PROJEKTIN “VENDOSJA E BUSTIT TË SKËNDERBEUT NË LONDËR, NË NËNTOR 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “projekte”, artikulli 604, t’i shtohet fondi prej 4 130 719 (katër milionë e njëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh, për “Westminster Council” për realizimin e projektit “Vendosja e bustit të Skënderbeut në Londër, në nëntor 2012”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 791, datë 14.11.2012

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË ORGANIKËS, SI DHE TË STRUKTURËS
E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Struktura e Autoritetit të Aviacionit Civil të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Autoritetit të Aviacionit Civil të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Struktura dhe nivelet e pagës të nëpunësve të Autoritetit të Aviacionit Civil të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Paga e grupit (kolona 1), e lidhjes nr.3, bashkëlidhur këtij vendimi, përcaktohet sipas lidhjes nr.5, bashkëlidhur këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2), e lidhjes nr.3, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
6. Shtesa për kualifikim (kolona 3), për titullarin dhe zëvendëstitullarin e institucionit, përfitohet sipas përcaktimeve të vendimit nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.
7. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.3.
8. Punonjësit mbështetës të Autoritetit të Aviacionit Civil të paguhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.
9. Vendimi nr.413, datë 26.5.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës e të organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA E AUTORITETIT TE AVIACIONIT CIVIL

LIDHJA NR.1





ORGANIKA E AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. DREJTOR EKZEKUTIV	II-a	<u>1</u>
II. DREJTORIA E KONTROLLIT TË CILËSISË DHE SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË		<u>(7)</u>
ZËVENDËSDREJTOR EKZEKUTIV/DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I KONTROLLIT TË CILËSISË		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
III. DREJTORIA E KONTROLLIT TË SHËRBIMIT TË LUNDRIMIT AJROR		<u>(9)</u>
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I KONTROLLIT TË PERSONELIT		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I INSPEKTIMIT TEKNIK		<u>(2)</u>
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I INSPEKTIMIT OPERACIONAL		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
IV. DREJTORIA E AEROPORTEVE DHE SIGURISË		<u>(8)</u>
DREJTOR	II-b	1

SEKTORI I SIGURISË DHE KOORDINIMIT TË EMERGJENCAVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I MBIKËQYRJES DHE CERTIFIKIMIT TË AEROPORTEVE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	3
V. DREJTORIA E SIGURISË AJRORE		(13)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I VLEFSHMËRISË AJRORE DHE MIRËMBAJTJES		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	4
SEKTORI OPERACIONAL DHE I CERTIFIKIMIT TË OPERATORËVE AJRORË		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I LICENCIMIT TË STAFIT DHE EKUIPAZHIT DHE MBIKËQYRJES AEROMJEKËSORE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	3
VI. DREJTORIA E STANDARDIZIMIT TEKNIK		(6)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I STANDARDIZIMIT TEKNIK PËR SIGURINE AJRORE DHE SHËRBIMIN E LUNDRIMIT AJROR		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I STANDARDIZIMIT TEKNIK PËR SIGURINË NË AVIACIONIN CIVIL DHE AEROPORTE		(2)
INSPEKTOR	III-b	2



VII. DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TRANSPORTIT AJROR		(6)
ZËVENDËSDREJTOR EKZEKUTIV/DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË MARRËVESHJEVE TË SHËRBIMEVE		(3)
AJRORE DHE AKTIVITETEVE TREGTARE TË AVIACIONIT NË AEROPORTE		
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I LICENCIMIT TË OPERATORËVE AJRORË DHE MBIKËQYRJES SË		
RREGULLOREVE TË SHËRBIMEVE NË TRANSPORTIN AJROR		(2)
INSPEKTOR	III-b	2
VIII. DREJTORIA E FINANCËS DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(16)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I PLANIFIKIMIT FINANCIAR, STATISTIKAVE, TARIFAVE DHE BUXHETIT		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORI I PËRFAQËSIMIT LIGJOR DHE PROKURIMEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE		(7)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SHOFER		3
PASTRUES		1
PUNONJËS GJITHSEJ		66

Lidhja nr. 3

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Autoritetin e Aviacionit Civil

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a		2%		107.300	15.000
Zevendestitullar i institucionit/Drejtor	II-b		2%		90.200	15.000
Drejtor Drejtorie.	II-b		2%	0	90.200	0
Pergjegjes Sektori.	III-a		2%	0	72.900	0
Pergjegjes Sektori.	III-a/1		2%	0	63.700	0
Inspektor. Specialist.	III-b		2%	0	55.500	0
Specialist.	IV-a		2%	0	44.300	0

Lidhja nr.4

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR.

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë



Lidhja nr.5

KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT
“SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI”.

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit	II-a	1
Zevendestitullar i institucionit/Drejtor	II-b	1
Drejtor Drejtorie.	II-b	1
Pergjegjes Sektori.	III-a	1
Pergjegjes Sektori	III-a/1	1
Inspektor. Specialist.	III-b	1 ose 2
Specialist.	IV-a	1 ose 2, ose 3

VENDIM Nr. 51, datë 7.11.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Admir Thanza	anëtar i “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Vladimir Kristo	anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 9.10.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 29 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Miranda Rabja, përfaqësuar nga avokat Anton Prekaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2010-719 (551), datë 28.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: nenet 42/1/2, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe e diskutoi atë në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 222, datë 23.12.2002, ka vendosur, ndër të tjera, deklarinimin fajtores të kërkuases për kryerjen e veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal (KP) dhe të marrëdhënieve seksuale me të mitura, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 100/2 i KP-së. Në zbatim të nenit 55/1/2 të KP-së ka vendosur, përfundimisht, dënimin e saj me 17 vjet burgim. Ky gjykim është zhvilluar në mungesë të kërkuases.

2. Kundër vendimit të lartpërmendur ka paraqitur ankim bashkë i pandehuri B.S. dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 145, datë 7.5.2003, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 222, datë 23.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për sa i përket këtij të pandehuri. Po ashtu, kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur ankim edhe bashkë i pandehuri tjetër F.N. dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 113, datë 11.04.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 222, datë 23.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për sa i përket të pandehurit F.N. dhe ka urdhëruar të kryhet pagesa e avokatit Veron Sadiraj, të caktuar kryesisht, për mbrojtjen e të pandehurve Besnik Kishta dhe Miranda Ribaj (Kishta).

3. Kërkuësja, në momentin që ka marrë dijeni për vendimin nr. 222, datë 23.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka filluar procedurat për rivendosjen në afat të të drejtës së ankimit ndaj këtij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 606, datë 19.6.2006, ka rivendosur në afat kërkuesen për të paraqitur ankim.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 426, datë 21.11.2007, bazuar në nenet 7 dhe 420 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuases, duke arsyetuar se çështja është shqyrtuar më parë nga kjo gjykatë, mbi bazën e ankimit të të pandehurve të tjerë B.S. dhe F.N. Sipas gjykatës së apelit, në këto gjykime interesat e të pandehurës Miranda Ribaj (Kishta) janë mbrojtur nga avokati i caktuar kryesisht dhe gjykata është shprehur në të dyja rastet në lidhje me vendimin e ankimit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr. 00-2010-719 (551), datë 28.5.2010, bazuar në nenin 433 të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësja, për arsye se ai nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit, sipas nenit 435/2 të KPP-së.

II

Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

6. ***Kërkuësja*** në datën 26.5.2012 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Ajo ka parashtruar se:

6.1 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke vendosur, në Dhomë Këshillimi, mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit, i ka mohuar asaj të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykatë, pra të drejtën për gjykim, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

6.2 Gjykata e Apelit Durrës ka keqinterpretuar nenin 7 të KPP-së, i cili parashikon ndalimin e gjykimit dy herë për të njëjtën vepër, pasi kjo gjykatë në dy gjykimet e mëparshme është shprehur vetëm për sa u përket dy të pandehurve B.S. dhe F.N. dhe jo për të pandehurit e tjerë, përfshirë kërkuesen.



6.3 Gjykata e Apelit Durrës ka kryer shkelje të rënda procedurale, sepse duke vendosur mospranimin e ankimit në momentin që çështja ishte në fazën e shqyrtimit të kërkesave paraprahe, ka cenuar të drejtën e saj për t'u dëgjuar para se të gjykohet.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë

7. Kërkuesja pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit për arsye se nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, i ka cenuar të drejtën për t'iu drejtuar asaj gjykate dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura prej saj në rekurs.

8. Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkueses në kuptim të standardeve që përkufizojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Ajo është shprehur, në jurisprudencën e saj, se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011*) dhe se mospranimi i një kërkesë në Gjykatën e Lartë nuk duhet të cenojë thelbin e të drejtës së ankimesit për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011*).

9. Po ashtu, Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në KPP, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Shqyrtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 24.7.2006; nr. 41, datë 28.9.2011*).

10. Gjykimimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedura e gjykimit që zhvillohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ka si veçori paraqitjen vetëm të shkaqeve të parashikuara në ligjet procedurale (shkelje të ligjit material ose procedural). Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por, për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 4.3.2008; nr. 10, datë 29.3.2011*).

11. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrihen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011*).

12. Gjykata tashmë ka vlerësuar se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon *inter alia* se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimin, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Neni 435/2 i KPP-së ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të

të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së, për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që dispijlojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407-421 të KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011*).

13. Në këtë vështrim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së, duke u shprehur se “Sekretaritetë e gjykatave, ku depozitohet ankimi, mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i panënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të KPP-së, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij”. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011*).

14. Gjykata ka theksuar se çdo interpretim i ndryshëm që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 të KPP-së, nuk i shërben garantimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. Referimi i bërë nga Kolegji Penal vetëm në kërkesat e nenit 435/2 të KPP-së, duke mos marrë në konsideratë kërkesat e nenit 432 të KPP-së për shqyrtimin e rekursit, cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 16.3.2011*).

15. Në rastin konkret, kërkuesja ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs, i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i saj. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, për këtë shkak ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja.

16. Për sa më sipër, në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe fjalitë vijuese e kësaj dispozite procedurale. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës nuk rezulton që Kolegji Penal të ketë vlerësuar veprimet e sekretarisë gjyqësore përkatëse për vënien në dijeni të kërkueses për mosplotësimin e kërkesës formale të nënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, në mënyrë që ajo të mund të bënte plotësimet e nevojshme. Për pasojë, Gjykata çmon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesja, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar asaj të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

B. Për pretendimet e tjera

17. Kërkuesja, edhe pse në objektin e kërkesës dhe në përfundimet e saj, kërkon vetëm shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, ngre pretendime edhe në lidhje me gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës. Ajo parashtrohet se kjo gjykatë ka kryer shkelje të rënda procedurale, sepse ka bazuar vendimin e saj në nenin 7 të KPP-së, i cili parashikon ndalimin e gjykimin dy herë për të njëjtën vepër, ndërkohë që në rastin objekt shqyrtimi nuk ekzistonin shkaqet e parashikuara nga kjo dispozitë, pasi në dy gjykimet e mëparshme gjykata e apelit është shprehur vetëm për sa u përket dy të pandehurve B.S. dhe F.N., të cilët kanë ushtruar efektivisht ankimin dhe jo për të



pandehurit e tjerë, përfshirë kërkuesen.

18. Gjithashtu, kërkuesja pretendon se gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit në momentin që çështja ishte në fazën e shqyrtimit të kërkesave paraprake, pra kur çështja nuk ishte kaluar akoma në seancë gjyqësore, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e saj për t'u dëgjuar para se të gjykohej.

19. Në këtë drejtim, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime që kanë të bëjnë me shkelje procedurale, të cilat janë të rëndësishme edhe për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 4, datë 28.2.2006 dhe nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë duhet të shprehet për qëndrimin e saj lidhur me këto pretendime të kërkueses.

20. Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkueses i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, si një standard kushtetues i procesit të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2010-719 (551), datë 28.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në këtë gjykatë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha.

VENDIM

Nr. 150, datë 31.10.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE PËR KONTRAKTIMIN E NJË KONSULENTI LIGJOR QË DO TË ASISTOJË ERE-N NË MOSMARRËVESHJET E KRIJUARA ME SHOQËRINË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 10 116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së 8130

Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 8.4.2009 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit në institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.10.2012, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat ligjore për kontraktimin e një zyre juridike me eksperiencë ndërkombëtare, e cila të mbështesë ERE-n me këshillimet e nevojshme juridike në lidhje me mosmarrëveshjet e krijuara me shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të marrë të gjitha masat ligjore për realizimin e kësaj procedure.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

NË MUNGESË, ME POROSI
Adriatik Bego

KËRKESË

Nr. 4488/1, datë 8.11.2012

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash-Morinë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar (ish-DPRR). Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për pasuritë për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ZPRVPP-së”, sqarojmë se do të merret edhe një herë konfirmimi për pronarët e këtyre pasurive.

Vlera totale e shpronësimit është 8 084 821 (tetë milionë e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
KALIMASH-MORINË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Objekte vlera lekë	Shënime
1	Mus	Tahir	Matmuja	1176	263/10	3825166	Rikonfirmim
2	Riza	Meme	Dida	1176	276	4259655	Rikonfirmim
		TOTALI				8084821	

KËRKESE

Shtetasi Ysni Korobacja, i datëlindjes 3.4.1956, i biri i Sadushit dhe i Rronjes, banues në fshatin Sheqishte, komuna Zharrëz-Fier, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier shpalljen të vdekur të djalit të tij z. Erion Korobacja i datëlindjes 1.4.1982.

KËRKUESI
Ysni Korobacja

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 19.11.2012
Doli nga shtypi më 19.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë